

L I G J
Nr.8250, datë 22.10.1997

**PËR PARASHKRIMIN E INTERESAVE DHE TË GJOBAVE TË VËNA PËR DEKLARIMIN
DHE PAGESËN MË VONESË TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR GJATË
PERIUDHËS SË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Parashkruhen të gjitha interesat e zbatuara dhe gjobat e vendosura lidhur me deklarimin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve të TVSH-së për periudhën tatimore shkurt-maj të vitit 1997, me kusht që deklarimi dhe pagesa e këtyre detyrimeve të bëhet brenda datës 14 dhjetor 1997.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1997.

**Shpallur me dekretin nr.1952, datë 27.10.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani.**